

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“TECHNOLOGY SOLUTIONS PROVIDER” SHPK**

Themeluesit që nënshkruajnë më poshtë:

- **Z. Gian Luigi ESPOSITO**, nënshtetas i Republikës së Italisë, i biri i Gaetano Esposito dhe i Michela Rispoli, i datëlindjes 22.06.1996, lindur në Madaaloni (CE)/Itali dhe banues në Madaaloni (CE)/Itali në adresën: Via Pioppolungi, 53 Madaaloni (CE)/Itali, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YC2273443, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili me kërkesë të tij asistohet nga përkthyesja e gjuhës italiane, e njohur dhe pranuar prej tij, znj. Klaudja BULKU, e bija e Zenel dhe Tatiana, lindur në Durrës dhe banuese në adresën: Rruga. “Rauf Fico”, Tiranë, mbajtëse Nr. 038243101 dhe Nr. Identifikimi Personal J45612017D, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Znj. Maria Giovanna ESPOSITO**, nënshtetase e Republikës së Italisë, e bija e Michele Esposito dhe Sherlett Davis, e datëlindjes 11.10.2004, lindur në Avellino (AV)/Itali dhe banuese në Sant’Agata De’ Goti (BN)//Itali në adresën: Contrada Piano, SNC Sant’Agata De’ Goti (BN)//Itali, mbajtëse e pasaportës italiane Nr. YB9253868, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila me kërkesë të saj, asistohet nga përkthyesja e gjuhës italiane, e njohur dhe pranuar prej saj, znj. Klaudja BULKU, e bija e Zenel dhe Tatiana, lindur në Durrës dhe banuese në adresën: Rruga “Rauf Fico”, Tiranë mbajtëse e Letërnjoftimit 038243101 dhe Nr. Identifikimi Personal J45612017D, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Sot më datë 16.02.2024, bazuar në vullnetin e tyre të lirë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar), vendosën të themelojnë Shoqërinë Tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

**Kreu I**

**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1.** Objekti i veprimtarisë.

Shoqëria tregtare “TECHNOLOGY SOLUTIONS PROVIDER” SHPK ka si objekt te veprimtarisë se saj:

- Ndërtimin, montazhin, përpilimin dhe projektimin e pajisjeve elektronike, elektromekanike, mekanike dhe industriale, si dhe pjesëve elektronike, elektromekanike dhe mekanike të çdo natyre dhe softuerëve;
- Tregtimin dhe/ose dhënien me qira të produkteve të lartpërmendura, përfshirë kompjuterët elektronikë, sistemet e arkivimit të të dhënave, rrjetet e transmetimit të



të dhënave dhe telefonisë, printerat, fotokopjet, mobiljet, mobiljet dhe pajisjet për zyrë, kasat e faturimit, peshore dhe pjesët e tyre, si dhe pajisjet për parkim dhe për biletat e transportit publik, si për shembull: timbruesit dhe kasat e lëshimit të biletave dhe softuerat e tyre;

- Tregtimin me shumicë dhe me pakicë të pjesëve të këmbimit, aksesoreve dhe materialeve konsumatore me pajisjet e sipërpërmendura.
- Dhënien dhe/ose ofrimin e shërbimit të ndihmës teknike, mirëmbajtjes dhe rregullimit të gjitha pajisjeve të lidhura me objektin shoqëror dhe softuerat e tyre;
- Organizimin dhe menaxhimin e kurseve të trajnimit;
- Kryerjen e të gjitha veprimtarive në lidhje me tregtimin e produkteve të lartpërmendura, përfshirë importin dhe eksportin e tyre;
- Sigurimin e figurave profesionale, si p.sh.: punonjësve të specializuar, teknikëve elektronikë, mekanikë dhe informatikë, sistemistëve, programuesve dhe menaxherëve të projekteve.
- Për të arritur qëllimin e saj, shoqëria mund të kontrakttojë agjenci, përfaqësi, mandate dhe kontrata komisioni nga kompani shqiptare dhe të huaja që operojnë në sektorët e sipërpërmendur dhe të marrë pjesë në tenderë publikë dhe privatë, përfshirë në sipërmarrje të përbashkëta.
- Kryerjen e çdo transaksioni të obligacioneve (letrave me vlere), titujve financiarë, duke aplikuar dhe financime të ndryshme;
- Mund të hyje në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushën e aktivitetit të saj;
- Import – Eksport , prodhim, transport e tregtim për të tretët me materialin e vet ose të porositësit;
- Shoqëria mund të kryejë për përmbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj operacioni tregtar, dhe për garantimin e tyre mund të vendosë peng ose barrë siguresë pasuri të luajtshme të sajat dhe/ose të lejojë vendosjen e barrës hipotekore mbi pasuritë e paluajtshme.
- Mund të hyje në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushën e aktivitetit të saj;
- Import-Eksport, prodhim, transport e tregtim për të tretët me materialin e vet ose të porositësit;
- Të marrë pjesë në ankande apo prokurime publike të zhvilluara nga organet përkatëse shtetërore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi

## **Neni 2.** Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

2.1. Ortakët vendosën që shoqërinë ta emërtojnë: “TECHNOLOGY SOLUTIONS PROVIDER” SHPK dhe të mbajnë emrin tregtar “T.P.S.” SHPK;

2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga “Perlat Rexhepi” Pallati Edil, Godina Nr. 1 shkalla Nr. 1, Apt. 52, Tiranë.

2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete, bashki apo njësi administrative të tjera të Republikës Shqiptarisë ose jashtë vendit.

### **Neni 3. Regjimi juridik**

3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

3.2. Me vendim të saj, Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme do të përshtatë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## **Kreu II TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

### **Neni 4 . Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve/Ortakut**

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

4.5. Ortaket/Ortaku marrin/merr pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

4.6. Ortakët/Ortaku kanë/ka të drejtë të marrin/marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike etj.

### **Neni 5. Kohëzgjatja**

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të Statutit të Shoqërisë.

## **Kreu III KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

## Neni 6

6.1. Shoqëria tregtare : “TECHNOLOGY SOLUTIONS PROVIDER” SHPK do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 100.000,00 i cili zotërohet tërësisht nga ortakët sipas specifikimeve në Statut dhe në këtë Akt Themelimi

6.2. Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është :

- Z. Gian Luigi ESPOSITO, 1 (një) kuotë në vlerën 50.000,00 (pesëdhjet mijë) Lekë e cila përbën dhe përkatësisht 50 ( pesëdhjetë) % (përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë
- Znj. Maria Giovanna ESPOSITO, 1 (një) kuotë në vlerën 50.000,00 (pesëdhjet mijë) Lekë e cila përbën dhe përkatësisht 50 (pesëdhjetë) % (përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë

6.3. Transferimi i kuotës së në tërësi, ose të një pjese të saj pas pjesëtimit të saj sipas nenit 75 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) nuk mund të realizohet nën vlerën nominale të saj. Vlera nominale e kuotës e zotëruar nga ortaku është e përcaktuar si më sipër (pika 6.2 e këtij neni). Vlera nominale e kuotës pas pjesëtimit përcaktohet në aktin e pjesëtimit.

## Kreu IV ORGANET E SHOQERISË

### Neni 7

7.1. Vendimet në Shoqëri merren nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Këto vendime shënohen ne regjistrin përkatës. Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht audituesi ligjor caktohet nga Asambleja e Përgjithshme.

7.2 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur që administratori i parë i shoqërisë të jetë, z. Giorgio MAGNIFICO, nënshtetas i Republikës së Italisë, i datëlindjes 05.04.1949, lindur në Torrevicchia Pia (PV)/Itali dhe banues në adresën: Mazllem Karaskai ND.13, H.2, Ap.12 Bilisht, 7006, Devoll/Korçë, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YA8181804 madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili do të ushtrojë detyrat me një mandat 5 (pesë) vjeçar

## Kreu V ADMINISTRIMI

### Neni 8

8.1 Administrimi i Shoqërisë do te behet ne përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

**Kreu VI**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**


9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet ortakëve të shoqërisë në përputhje me pjesët e tyre takuese.

9.2. Ky Akt shtypet dhe firmoset ne 4 (katër) kopje, te gjitha me te njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron ne dokumentacionin bazë te Shoqërisë.

9.3 Autorizohet administratori, z. Giorgio Magnifico, ose ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij, të ndjekë procedurat e duhura për regjistrimin e kësaj shoqërie pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Për realizimin e saj, ai ka të drejtë të emërojë apo caktojë dhe persona të tjerë.


**THEMELUESIT**

**Z. Gian Luigi ESPOSITO**



---

**Znj. Maria Giovanna ESPOSITO**



---

Asistoi përkthyesja e gjuhës italiane: **Znj. Klaudja BULKU**



